



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.539/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Milot Deliut, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, për shkak të mospërputhjes së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 31.10.2017 mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Milot Deliut, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Shtime, me numër ZL.Anr.539/2017 e datës 27.10.2017, për shkak të mospërputhjes së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 27.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Milot Deliu, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se në vendvotimin nr.2201X/02R, në Shkollën “Emin Duraku”, ka mospërputhje të votave të subjektit të PDK-së me nr. e votave të anëtarëve për Kuvendin Komunal. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se në këtë vendvotim nr. i votave të subjektit politik PDK është 24 ndërsa nr. i votave të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal është 175. Si dëshmi ankuesi ka bashkangjitur formularët e të dhënave dhe rezultateve.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkritazi me manipulimin e votave në vendvotimin 2201X/02R, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Milot Deliu, nuk e paragjykon çështjen dhe

ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.539/2017 me datën 31.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa .